



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore
Me datë 14.7.2022

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Burim Koci	Mës. Gjeografi	Turizmi si mjet simplifikues në të nxënit e gjeografisë së Kosovës, klasa e IX.	Kryetar/e	Bahtije Gerbeshi
				Mentor/e	Florim Isufi
				Anetar/e	Teuta Danuza
2	Avni Hasani	Mës. Gjeografi	TEKSTET E GJEOGRAFISË PËR KLASËN E XI DHE PËRSHTATSHMËRIA E TYRE ME KURRIKULËN E RE	Kryetar/e	Florim Isufi
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Vjollca Ahmedi
3	Rina Zeneli	Mës. Tekn.TIK	Ndikimi i projekteve në shtëpi në avancimin e mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë	Kryetar/e	Florent Bunjaku
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Vlora Sylaj
4	Fatijon Haklaj	Mës. Matematikë	Shkathësitë e mësimdhënësve para shërbimit dhe pikëpamjet e tyre për shtrimin e problemeve të modelimit matematikor	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Eda Vula
				Anetar/e	Teuta Danuza
5	Dizare Pakashtica	Mës. Matematikë	Pikëpamjet e mësimdhënësve rreth ndikimit të mësimi bazuar në projekte nga lënda e matematikës në shkollat e mesme të larta	Kryetar/e	Eda Vula
				Mentor/e	Fahri Marevci
				Anetar/e	Ganimete Kulinxha
6	Besëlidhje Balaj	Mës. Matematikë	Ndikimi i aplikacionit Symbolab në ngritjen e njohurive të nxënësve me fokus te matricat dhe veprimet me to	Kryetar/e	Eda Vula
				Mentor/e	Fahri Marevci
				Anetar/e	Vlora Sylaj
7	Valentina Hajdari	Mës. Histori	Ndërgjegjësimi i nxënësve lidhur me rolin e mendësisë në motivimin e tyre në të nxënit e lëndës së historisë	Kryetar/e	Sedat Baraliu
				Mentor/e	Bahtije Gerbeshi
				Anetar/e	Veli Kryeziu
8	Alban Murati	Mës. Histori	Ndikimi i portfolios si instrument vlerësimi në të nxënit e lëndës së historisë	Kryetar/e	Veli Kryeziu
				Mentor/e	Bahtije Gerbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
9	Avdullah Dautaj	Mës. Histori	Pikëpamjet e mësimdhënësve dhe të nxënësve lidhur me rolin e burimeve historike në zhvillimin e të menduarit historik të nxënësve në shkolla të mesme të larta	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Bahtije Gerbeshi
				Anetar/e	Minevere Rashiti
10	Nusret Mulaki	Mës. Histori	"Roli i filmit dokumentar në të nxënit e lëndës së historisë sipas perceptimit të mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave të mesme të larta"	Kryetar/e	Sedat Baraliu
				Mentor/e	Bahtije Gerbeshi
				Anetar/e	Illir Muharremi
11	Delvina Pajaziti	Mës. Histori	Strategjitë mësimore në funksion të motivimit të nxënësve në të nxënit e lëndës së historisë sipas	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Bahtije Gerbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj

			perceptimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve		
12	Albana Podvorica	Mës. Histori	Ndikimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin e njohurive të nxënësve të klasës së VI-të për trashëgiminë kulturore	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Sedat Baraliu
				Anetar/e	Veli Kryeziu
13	Mirlinda Sadiku	Mës. Histori	Ndërlidhja e lëndës së Historisë me trashëgimin kulturore, në funksion të zhvillimit të kompetencës qytetare	Kryetar/e	Bahtije Gerbeshi
				Mentor/e	Sedat Baraliu
				Anetar/e	Veli Kryeziu
14	Rina Ramshaj	Mës. Tekn.TIK	"Niveli i përdorimit të portfolios elektronike në vlerësimin e nxënësve gjatë pandemisë COVID-19"	Kryetar/e	Kyvette Shatri
				Mentor/e	Kastriot Buza
				Anetar/e	Ganimete Kulinxha
15	Dorentina Aliu	Mës. Biologji	Qëndrimet dhe njohuritë e nxënësve të klasave të IX-ta në lidhje me efektet e duhanpirjes në shëndet dhe mjedis	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Zeqir Veselaj
				Anetar/e	Naser Zabeli
16	Demir Demiri	Mës. Gjeografi	"Përceptimet e nxënësve në lidhje me ndikimin e emocioneve pozitive në të nxënit e lëndës së gjeografisë"	Kryetar/e	Arsim Ejupi
				Mentor/e	Teuta Danuza
				Anetar/e	Minevere Rashiti
17	Mirlinda Alija	Mës. Kimi	"Ndikimi i të nxënit të bazuar në kërkim në të nxënit për strukturat e komponimeve organike"	Kryetar/e	Eda Vula
				Mentor/e	Arlinda Damoni
				Anetar/e	Jehona-Ferizi Miftari
18	Shahire Morina-Paçarizi	Mës. GJLSH	Sintaksa në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Naser Pajaziti
				Mentor/e	Xhavit Beqiri
				Anetar/e	Vjollca Ahmedi

Kandidati/ja: 1. Burim Koci

Tema: Turizmi si mjet simplifikues në të nxënit e gjeografisë së Kosovës, klasa e IX.

ABSTRAKT

Turizmi sot përbën një nga fenomenet më masive të rruzullit tokësor, dhe si i tillë ka vëmendje të veçantë nga njerëzit e të gjitha moshave e sidomos nga të rinjtë, në rastin tonë nxënësit. Duke parë që metodat klasike të shpjegimit të lëndës së Gjeografisë janë konsumuar dhe e kanë transformuar gjeografinë në lëndë monotone, e kemi parë të domosdoshme për të hulumtuar se sa e përdorin mësimdhënësit fushën e turizmit dhe atraktivitetin e tij gjatë shpjegimit, në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara, pra të nxënit e gjeografisë së Kosovës nga materiali ku shtjellohet Kosova, në klasën e IX. Synim i çdo mësimdhënësi është që ta ketë vëmendjen e plotë të nxënësve të tij, e këtu qëndron përparësia e përdorimit të turizmit si pjesë e procesit mësimor. Një nxënës do ta ketë më të lehtë që të absorbojë njohuri dhe t'i transmetojë ato vetëm me anë të një fenomeni që është "trend" pra, turizmi. Me anë të përdorimit të turizmit nxënësi do ta ketë më të lehtë të mendojë si gjeograf e të veproj si i tillë.

FJALËT KYÇE: Turizëm, mësimdhënësi, nxënës

Kandidati/ja: 2. Avni Hashani

Tema: Tekstet e gjeografisë për klasën e XI dhe përshtatshmëria e tyre me kurrikulën e re

ABSTRAKTI

Ndër mjetet bazë dhe orientues në procesin mësimor, përkundër teknikave të përparuara dhe të sofistikuar mbetet teksti. Mirëpo, ndonjëherë shkrimi i tyre nuk përkon me atë, që do të mësojnë nxënësit, ose ka mangësi, ose tepriçë në librin shkollor. Prandaj edhe unë e pashë të arsyshme të bëjë hulumtimin se sa janë të përshtatshëm librat e Gjeografisë për klasën e XI me kurrikulën e re. Shkruarja e librave shkollorë duhet të mbështetet në disa kritere dhe si kriter bazë duhet të merret aftësia kuptimore e nxënësit. Së pari i kam njoftuar mësimdhënësit dhe nxënësit lidhur me hulumtimin e lartcekur, e cila ka për qëllim ta dimë përshtatshmërinë e teksteve të gjeografisë me kurrikulën e re.

Metodologjia e hulumtimit realizuar në përdorim të metodave të kombinuara dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Këto metoda janë: Metoda kualitative dhe kuantitative. Si instrumente matëse kemi përdorur pyetësorët për nxënësit dhe mësimdhënësit, përmes të cilëve do të identifikohen vështirësitë që i hasin mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë përdorimit të tekstit të gjeografisë.

Pyetja hulumtuese: A kanë tekstet e gjeografisë gabime drejtshkrimore, përmbajtje dhe në figura dhe Sa i përshtaten kurrikulës tekstet e gjeografisë për nivelin e XI? Gjatë procesit të hulumtimit kemi gjetur përgjigjen edhe të pyetjeve të tjera me rëndësi si psh : Sa ofrojnë tekstet e gjeografisë njohje të harmonizuara me rezultatet e parapara sipas kompetencave kryesore në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, Jo më pak e rëndësishme është se kuptuam se sa ndihmojnë tekstet shkollorë të gjeografisë në zotërimin e bindjeve dhe qëndrimeve shkencore për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Nga pikëpamja e metodologjisë, për këtë studim kemi përdorur metoda sasiore (pyetësori). Instrumentet matëse do të jenë kriteret e caktuara për Analizë e teksteve shkollorë të Gjeografisë për klasën e XI si dhe Pyetësori për nxënësit dhe mësimdhënësit të Shkollës së Mesme të Larta” Kuvendi i Arbëri” në Komunën e Ferizajit. Nga ky studim kemi kuptuar se sa i përshtaten tekstet e gjeografisë kurrikulës së re me qëllim të motivimit, nxitjes dhe arritjes së rezultateve në procesin edukativo – arsimor. Rezultatet e studimit tregojnë se, komuna e Ferizajit si të gjitha qytet e tjera të Kosovës duhet t’i kushtojnë rëndësi të veçantë procesit të mësimdhënies, dhe teksti i gjeografisë të jetë i përshtatshëm me kurrikulën e re.

Sipas këtij hulumtimi rekomandohet që teksti i gjeografisë të jetë i përshtatshëm me kurrikulën e re dhe në përmbajtjen e saj të posedoj më shumë harta dhe figura.

Fjalët kyçe: Gjeografia, kurrikula, mësimdhënësi, nxënësi, teksti.

Kandidati/ja: 3. Rina Zeneli

Tema: **Ndikimi i projekteve në shtëpi në avancimin e mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë**

ABSTRAKTI

Në zhvillimet e përgjithshme shoqërore, politike, ekonomike, shkencore e teknologjike, është më se e domosdoshme edhe ndryshimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shkolla duhet të jetë në hap me këto ndryshime, përndryshe nuk do të mund ta luaj rolin dhe funksionin e saj edukativo-arsimor.

Duke u bazuar në faktin se çdo nxënës ka mënyrën e vet të të nxënit, të mësuarit është i frytshëm nëse të folurit, bisedat, shoqërohen, ndërlihen me veprimet, ushtrimet dhe duke punuar, vepruar me to etj. Mësimdhënësi mund dhe duhet t'a përdorë stilin e të nxënit të fëmijës për t'a inkurajuar atë për të nxënë, për t'a motivuar dhe për t'a bërë që të ndjehet i suksesshëm. Krejt kjo mund të arrihet në procesin e mësimdhënies nëse përdorim shumë metoda, teknika, eksperimente, që në teorinë pedagogjike përdorimi i tyre ndikon në planifikimin dhe organizimin e mësimdhënies bashkëkohore. Disa prej tyre janë mësimdhënia ndërvepruese, mësimdhënia e diferencuar, mësimdhënia e integruar, mësimdhënia tematike, mësimdhënia dhe të nxënit përmes projekteve etj. Kjo e fundit nënkupton përfshirjen e nxënësve në veprimtaritë grupore ose individuale, përmes të cilave nxënësit mësojnë duke krijuar risi, gjëra të reja. Nxënësit duke bashkëpunuar në grup ose si individ përdorin burime të ndryshme të informacionit për t'i zgjidhur vet problemet. Ky mësim i tërheq nxënësit, i nxit për dituri të reja përmes ndërveprimit.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të shqyrtohen dhe hulumtohen ndikimet e projekteve nga shtëpia të cilat po realizohen tani, varësisht nga kërkesat e mësimdhënësit, ndërsa kreativiteti dhe pjesa e hulumtimit mbetet sipas punës që realizon nxënësi. Kuazi eksperimental është dizajni i hulumtimit i cili do të realizohet me metoda të përziera: sasiore dhe cilësore. Hulumtimi do të realizohet me klasat e VIII-ta në shkollën fillore të mesme të ulët "Abdullah Shabani" në Mitrovicë të cilat do të numrohen si mostra të qëllimshme, ku disa klasa të VII-ta kanë rolin e grupit eksperimental kurse disa kanë rolin e grupit të kontrollit. Si instrumente të mbledhjes së të dhënave do të përdorim dy teste : paratesti, pastesti, metodën e vëzhgimit në të dy klasët si dhe intervista për mësimdhënësit.

Rezultatet e këtij studimi kanë treguar se si realizimi i projekteve në shtëpi ndikon pozitivisht në mbamendjen, motivimin dhe interesimin e nxënësve për të mësuar.

Fjalët kyçe: Ndikim, avancim, projekte, mësimdhënia, mësimnxënia.

Kandidati/ja: 4. Fatijon Haklaj

Tema: **Shkathësitë e mësimdhënësve para shërbimit dhe pikëpamjet e tyre për shtrimin e problemeve të modelimit matematikor**

ABSTRAKTI

Zbatimi i një mësimdhënie bashkëkohore lidhet ngushtë me përgatitjen akademike të mësimdhënësve para shërbimit. Edhe për mësimdhënie të matematikës, mësimdhënësit para shërbimit duhet të jenë jashtëzakonisht të përgatitur në përmbushjen e kërkesave kurrikulare në kuadër të fushës së matematikës. Modelimi matematikor është një prej kompetencave matematikore të cilat nxënësit e nivelit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë duhet ta zotërojnë. Në arritjen e kësaj kompetence rol jashtëzakonisht të rëndësishëm kanë mësimdhënësit. Një mësimdhënës mirë i informuar lidhur me problemet e modelimit matematikor dhe mirë i trajnuar në shtrimin e problemeve të tilla paraqet çelësin e suksesit në arritjen e kompetencës së modelimit matematikor nga nxënësit. Kështu qëllimi parësor i këtij hulumtimi është analiza e shkathësive të mësimdhënësve para shërbimit në shtrimin e problemeve të modelimit matematikor. Nxjerrja në pah e pikëpamjeve të mësimdhënësve para shërbimit në lidhje me shtrimin e problemeve dhe procesin e modelimit matematikor për zgjidhjen e tyre është një qëllim tjetër i këtij hulumtimi, pasi që nga to mund të marrim të dhëna lidhur me disponimin dhe motivimin e tyre për tu marrë me probleme të tilla gjatë punës së tyre si mësimdhënës në të ardhmen.

Hulumtimi është bazuar në modelin jo-eksperimental të qasjes cilësore për të analizuar problemet e shtruara nga pjesëmarrësit e studimit, zgjidhja e të cilave bazohet në modelimet matematikore.

Ndërkaq, përgjigjet e pyetjeve të hapura për pikëpamjet për modelimet matematikore janë analizuar me qasjen induktive për analizë të përmbajtjes. Rezultatet treguan se mësimdhënësit para shërbimit kanë njohuri të mira për përmbajtjen matematikore në kuadër të programeve mësimore të shkallëve 3,4,5 dhe 6 dhe numri i temave përkatësisht koncepteve të përfshira në problemet e shtruara tregojnë për mundësinë e madhe të zbatimit të modelimit matematikor në mësimdhënien e matematikës. Ndërkaq, nga analiza e pyetësorëve, procesi i modelimit matematikor shihet si rrugë ideale për të nxënësit e thellë dhe kuptimplotë të matematikës, edhe pse në disa raste procesi konsiderohet të jetë sfidues.

Fjalët kyçe : Modelim matematikor, shtrim i problemeve, mësimdhënës para shërbimit

Kandidati/ja: 5. Dizare Pakashtica

Tema: Pikëpamjet e mësimeve rreth ndikimit të mësimit bazuar në projekte nga lënda e matematikës në shkollat e mesme të larta

ABSTRAKTI

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të shqyrtojë pikëpamjet e mësimeve rreth ndikimit të mësimeve së bazuar në projekte në arrijtjet e nxënësve në fushën e matematikës në SHML. Hulumtimi është zhvilluar me mësimeve të matematikës së shkollave të mesme të larta në nivel vendi. Si instrument për grumbullimin e të dhënave është përdorur pyetësi i ndërtuar enkas dhe intervista me mësimeve. Numri i mësimeve të cilët kanë marr pjesë në plotësimin e pyetësit është 115, 105 mësimeve nga institucionet publike dhe 10 nga institucionet private. Ndërsa i kemi intervistuar 5 mësimeve, 4 nga institucionet publike dhe 1 nga ato private. Analiza e rezultateve është bërë duke përdorur programin e statistikor SPSS, konkretisht modelet Descriptive dhe Anova; që mundësuan shqyrtimin e relacioneve ndërmjet variablove. Të gjeturat na ofruan një pasqyrë të kompletuar e të hollësishme të perceptimeve të mësimeve në lidhje me mësimin e bazuar në projekte.

Hulumtimi është kombinim i metodës kualitative dhe kuantitative. Perceptimet e mësimeve të anketuar në lidhje me përdorimin e projekteve mësimore në lëndën e matematikës në shkollat e mesme të larta ishin tejet pozitive. Të dhënat e hulumtimit treguan që perceptimi i mësimeve në lidhje me arrijtjen e kompetencave dhe qëllimeve të arsimit parauniversitar përmes projekteve në lëndën e matematikës ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të mësimeve të anketuar të moshës 21-30 vjeç dhe mësimeve të moshës 51-65 vjeç. Po ashtu, dallime statistikisht të rëndësishme kishte edhe në mes të mësimeve të trajnuar dhe atyre të pa trajnuar. Mësimeve me kualifikim master e përdorin më shumë këtë formë të mësimeve.

Në kuadër të realizimit të hulumtimit, shfrytëzuam literaturën kombëtare si dhe ndërkombëtare adekuate për temën.

Fjalët kyçe: mësimeve, matematikë, projekte, nxënës.

Kandidati/ja: 6. Besëlidhje Balaj

Tema: Ndikimi i aplikacionit Symbolab në ngritjen e njohurive të nxënësve me fokus te matricat dhe veprimet me to

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është shqyrtimi i ndikimit të aplikacionit Symbolab në të nxënët e matematikës. Në veçanti, hulumtimi ka identifikuar në mënyrë të detajuar ndikimin e aplikacionit Symbolab në ngritjen e njohurive të nxënësve me fokus matricat dhe veprimet me to. Më saktë, hulumtimi ishte një tregues për matjen dhe përputhjen e inkuadrimin të aplikacionit në fjalë si një

lehtësues në lidhje me veprimet me matrica.

Për të realizuar hulumtimin është shfrytëzuar metodologjia e hulumtimit në veprim me dizajnin kuazi-eksperimental. Pjesëmarrës në hulumtim ishin gjithsej 42 nxënës, të dy klasave të njëmbëdhjeta (11) të gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, gjuha amëtare e të cilëve ishte gjuha shqipe. Njëra klasë përbëhej nga 22 nxënës ndërsa klasa tjetër kishte gjithsej 20 nxënës.

Në fillim të këtij hulumtimi është realizuar një para-test dhe pas intervenimit një pas-test për të vlerësuar përmirësimin e rezultateve të nxënësve. Gjithashtu, në fund të këtij hulumtimi është realizuar dhe një pyetësor për të mbledhur dhe shqyrtuar mendimet e nxënësve lidhur me përdorimin e aplikacioneve të ndryshme me theks të veçantë rreth aplikacionit Symbolab.

Sipas rezultateve të analizave të bëra ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mesatares së pikëve të fituara në para-test dhe atyre në pas-test, po ashtu me anë të instrumentit të hulumtimit (pyetësorit), vërejmë që një numër i madh i nxënësve dhanë vlerësime pozitive për këtë aplikacion.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e nxënësve ishin të mendimit që do të vazhdojnë ta përdorin këtë aplikacion edhe në vitet në vazhdim.

Fjalët kyçe: aplikacioni Symbolab, matricat, veprimet me matrica, nxënës.

Kandidati/ja: 7. Valentina Hajdari

Tema: Ndërgjegjësimi i nxënësve lidhur me rolin e mendësisë në motivimin e tyre në të nxënit e lëndës së historisë

ABSTRAKTI

Vitet e fundit po bëhen hulumtime të shumta në lidhje me ndikimin e intervenimeve të mendësisë së rritjes nëpër të cilat po demonstron potenciali i tyre në motivimin e brendshëm të nxënësve dhe në përmirësimin e pasqyrës së suksesit nëpër shkollë; Po paraqitet nevoja e interesimit të mësimdhënësve në përvojën e nxënësve në shkollë dhe gjatë të mësuarit; Po sugjerohet përdorimi i metodave të mësimdhënies që ndikojnë në vet-rregullimin e nxënësve për të gjetur strategjitë e përshtatshme të të mësuarit, etj. Duke pasur parasyshë mungesën e hulumtimeve të tilla në vendin tonë, ku ende ekziston ideja se intelegjenca është e lindur, si pasojë e së cilës shumë mësimdhënës aplikojnë udhëzime njëdimensionale të mësimdhënies, përmes të cilave nuk ofrojnë mundësi që nxënësit të gjejnë metodat e përshtatshme të të mësuarit dhe kështu ndikojnë që ata të krijojnë mendësinë fikse në lidhje me mungesën e aftësisë të nevojshme për të qenë të suksesshëm në lëndë të caktuara, kemi vendosur të bëjmë një eksperiment për të verifikuar se si mendësia e rritjes dhe udhëzimet shumëdimensionale të mësimdhënësit mund të ndikojnë në ndryshimin e perceptimit të natyrës së lëndës së historisë, e cila vazhdon të perceptohet si "lëndë e mërzitshme", "teorike", "me shumë data", etj.

Në këtë eksperiment kanë marrë pjesë nxënësit e klasave 9/2 të SHFMU "Dëshmorët e Kombit", në Livoç të Ulët dhe SHFMU "Ramiz Cërrnica", në Cërrnicë, Komuna e Gjilanit, përmes të cilit kemi provuar ndikimin e aplikimit të programit tetë javor "Neuroshkenca", në kuadër të të cilit janë implemetuar 8 orë mësimi, ku nxënësit kanë mësuar për fleksibilitetin e trurit dhe zhvillimin e tij përmes të mësuarit, si dhe 8 orë mësimi të lëndës së historisë, gjatë të cilave janë aplikuar metodat e mësimdhënies brenda kornizës së mendësisë së rritjes, ku nxënësit kanë marrë udhëzime shumëdimensionale për të mësuar këtë lëndë.

Në hulumtim janë përfshirë edhe nxënësit e klasave 9/1, të cilët pa iu nënshtruar eksperimentit iu kanë përgjigjur para dhe pas pyetësorëve të njëjtë, si dhe para dhe pas testeve të njëjta vlerësuese. Krahasimi i rezultateve sasiore në mes të këtyre dy grupeve ka treguar se intervenimet në mendësi ndikojnë në tri komponentët e mendësisë së rritjes, që janë: motivimi i brendshëm, qëndrimi pozitiv kundrejt historisë dhe perceptimi shumdimensional i natyrës së historisë që janë manifestuar në rritje të suksesit në pas-test për mbi 50%.

Fjalët kyçe: nxënësit, mendësia, motivimi, të nxënit, lënda e historisë

Kandidati/ja: 8. Alban Murati

Tema: Ndikimi i portfolios si instrument vlerësimi në të nxënit e lëndës së historisë

ABSTRAKTI

Me kalimin e viteve, si çdo sferë edhe sistemi i edukimit dhe arsimit të një vendi ndryshon në raport me zhvillimet që po ndodhin çdo ditë e më shumë në shkencë dhe në teknologji. Krahas këtij zhvillimi në fushën e edukimit, zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive dhe shkathtësive të nxënësve, si dhe nxitja për formim nga aktiviteti vetjak po dërgon në nevojën të formave apo instrumenteve të ndryshme të vlerësimit në mënyrë që nxënësve t'u formohet mendimi krijues dhe kreativ. Një prej instrumenteve të vlerësimit që po përdoret në mësimdhënien bashkëkohore padyshim është edhe portfolio, e cila ndikon në mënyrë të jashtëzakonshme në formimin e mendimit individual tek nxënësit. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të hulumtojmë, të paraqesim dhe të ndriçojmë këndvështrimet e mësimdhënësve të historisë lidhur me përdorimin e portfolios si instrument vlerësimi, si dhe rëndësinë që ka ky instrument në të nxënit e nxënësve në lëndën e historisë. Po ashtu ky hulumtim ka për qëllim të paraqes edhe mendimet e nxënësve lidhur me ndikimin e portfolios në shfaqjen e potencialit të të nxënit të tyre në lëndën e historisë. Sa i përket metodologjisë, ky hulumtim është hulumtim me metoda të përziera. Pra, është realizuar me anë të metodave sasiore dhe cilësore. Në këtë hulumtim si instrument matës do të përdoret pyetësori për nxënës dhe intervista për mësimdhënës. Pjesë e këtij hulumtimi kanë qenë gjithsej 252 respondentë (nxënës) dhe 7 mësimdhënës në tri shkolla të mesme të larta në Komunën e Podujevës dhe në Komunën e Prishtinës. Rezultatet e fituara nga hulumtimi tregojnë që përdorimi i portfolios si instrument vlerësimi ka ndikim shumë të madh në të nxënit e nxënësve në lëndën e historisë.

Fjalët kyçe: hulumtimi, mësimdhënësi, nxënësi, portfolio, vlerësimi.

Kandidati/ja: 9. Avdullah Dautaj

Tema: Pikëpamjet e mësimdhënësve dhe të nxënësve lidhur me rolin e burimeve historike në zhvillimin e të menduarit historik të nxënësve në shkolla të mesme të larta

ABSTRAKTI

Shekulli në të cilin po jetojmë, ndryshe njihet edhe si “shekulli i informacionit”, për arsye sepse sot si kurrë më herët jemi shumë pranë informacioneve të ndryshme. Në shumicën e rëndësishme është që të dijmë edhe burimin e tyre. Informacionet në lëndën e historisë bazohen në burimet historike që ndahen në 3 lloje, e të cilat janë: burimet materiale, burimet e shkruara dhe burimet gojore. Të gjitha këto burime kur përdoren në lëndën e historisë, ndikojnë në zhvillimin e të menduarit historik të nxënësve.

Në hyrje të hulumtimit është theksuar roli i burimeve historike në zhvillimin e të menduarit historik të nxënësve në shkolla të mesme të larta. Në shqyrtimin e literaturës janë përfshirë 4 nënkapituj, duke filluar nga të menduarit historik dhe zhvillimi tij, zbatimi në mësimdhënie, rolin e burimeve historike dhe llojet e tyre. Është treguar edhe metodologjia e hulumtimit, ku janë përshkruar procedurat gjatë punimit. Pasi janë përgjigjur nxënësit në pyetësor dhe mësimdhënësit në intervista është nxjerrur analiza e të dhënave, e në fund në bazë të gjithë këtyre procedurave janë përmbledhur diskutimet dhe konkludimet.

Ky hulumtim u realizua me anë të metodologjisë sasiore dhe cilësore, ndërsa si instrument matës është pyetësori për nxënës dhe intervista e gjysmëstruktuar për mësimdhënës.

Në hulumtim gjithsej janë 180 respondentë, në 4 shkolla të mesme të larta, më saktësisht në Sh.M.L “Vëllezërit Frashëri” në Deçan, Sh.M.L “Bedri Pejani” në Pejë, Sh.M.L “Hajdar Dushi” në Gjakovë dhe Sh.M.L “Kuvendi i Junikut” në Junik. Gjithashtu janë intervistuar 7 mësimdhënës, ku pytetjet të gjitha kanë qenë të hapura duke u bazuar edhe në mendimin kritik të tyre.

Nga ky hulumtim janë nxjerrur rezultate prej nga e kemi shiquar se cili është roli i përdorimit të burimeve historike në zhvillimin e të menduarit historik të nxënësve; sa janë të përgaditur nxënësit për të i kuptuar temat mësimore kur përdoren burime tjera jashtë librit bazë dhe sa e zbatojnë këtë metodë mësimdhënësit për të realizuar një mesimnxënie të suksesshme.

Fjalët kyçe: burimet historike, mendimi historik, nxënësit, mësimdhënësit, shkolla.

Kandidati/ja: 10. Nusret Mulaki

Tema: Roli i filmit dokumentar në të nxënit e lëndës së historisë sipas perceptimit të mësimit dhe nxënësve të shkollave të mesme të larta

ABSTRAKTI

Njeriu çdoherë është i prirur të kuptojë më mirë ndonjë informacion të rëndësishëm kur ai është i materializuar, pra, i atillë që mund të vrojtohet nga shqisat pamore. Vetë struktura e krijimit të njeriut është e tillë, prandaj edhe hulumtimi i kësaj teme ngritet mbi këtë premisë themeltare.

Ky punim në prizëm të trajtimit dhe si qëllim kishte dhënie e përgjigjes kësaj pyetjeje themelore: “Çfarë roli ka filmi dokumentar në të nxënit e lëndës së historisë?”. Po ashtu si pyetje ndihmëse të hulumtimit në punim kishim: Cilat janë pikëpamjet e mësimit dhe të nxënësve për filmin dokumentar dhe Sa ka zbatueshmëri efektive në mësimit dhe historisë filmi dokumentar.

Hipotezat mbi të cilën është ngritur ky punim janë: “Filmi dokumentar ka ndikim pozitiv në të nxënit e lëndës së historisë” si dhe “Filmi dokumentar gjë zbatueshmëri të madhe në lëndën e historisë”.

Lloji i mostrës që është përdorur është mostra e qëllimshme, nënloji mostra e përshtatshme. Si popullatë e studimit kanë qenë shkollat e mesme të larta të profilit shoqëror të këtyre komunave të Republikës së Kosovës, konkretisht gjimnazet: “Dardania”- Hani i Elezit, “Skënderbeu”- Kaçanik, “Dr.Shaban Hashani”- Ferizaj dhe “Ahmet Hoxha”- Prishtinë.

Konkretisht ishin 7 mësimit, ndërsa grupin respondent e përbejnë 264 nxënës. Metodologjia; punimi ka ngërthyer qasjen cilësore dhe sasiore të hulumtimit, pra, qasjen me metoda të përziera apo mikse. Janë përdorur metodat e përshkrimit, të analizës deskriptive dhe statistikore.

Instrumentet e hulumtimit të përdorura janë: Pyetësori i strukturuar për nxënës, si dhe Intervista gjysëm e strukturuar për mësimit.

Analizimi i rezultateve sasiore të përgjigjeve të pyetësorit me programin SPSS V.25 dhe intervistave me mësimit me metodat e lartpërmendura kanë treguar se hipotezat janë të qëndrueshme dhe të sakta, si dhe pyetjet e hulumtimit mbi rolin dhe zbatueshmërinë në orë mësimore të filmit dokumentar kanë marrë përgjigje mjaftë pozitive.

Andaj duke u bazuar në këto të gjetura rekomandohet të vazhdohet me tej kjo praktikë mësimore, si dhe të zbatohen rekomandimet të nxjerruara nga ky hulumtim për përmirësimin e mëtejshëm të kësaj praktike mësimore.

Fjalët kyçe: filmi dokumentar, mësimit, nxënës, roli, zbatueshmëria, të nxënit.

Kandidati/ja: 11. Delvina Pajaziti

Tema: Strategjitë mësimore në funksion të motivimit të nxënësve në të nxënit e lëndës së historisë sipas perceptimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve

ABSTRAKTI

Përdorimi i strategjive dhe teknikave të ndryshme mësimore është shumë i rëndësishëm për motivimin e nxënësve si dhe nxitjen e kureshtjes së tyre. Përdorimi i teknikave bashëkohore të mësimin është i domosdoshëm për rritjen e produktivitetit të mësimin, sidomos tek lëndët shoqërore siq është lënda e historisë. Qëllimi i këtij punimi ishte trajtimi i rëndësisë që kanë strategjitë mësimore në funksion të motivimit të nxënësve në lëndën e historisë, ku analiza e hulumtimit ishte realizuar në dy drejtime; (i) sipas perceptimit të mësimdhënësve dhe (ii) sipas perceptimit të nxënësve. Metodologjia e hulumtimit ishte kryesisht hulumtuese, ku mostra e hulumtimit ishte 220, prej të cilëve 30 ishin mësimdhënës, ndërkaq 190 ishin nxënës.

Janë përdorur dy pyetësor të ndarë, ku njëri ishte i dizajnuar për mësimdhënësit ndërkaq tjetri ishte i dizajnuar për nxënësit. Analiza e rezultateve është bërë me anë të programit SPSS, ku përfshihen përshkrim i të dhënave në frekuenca dhe përqindje, besueshmëri e të dhënave, dallime statistikisht të rëndësishme, analizë e korrelacionit, paraqitje grafike etj.

Rezultatet nga analiza e hulumtimit tregojnë se strategjitë mësimore luajnë rol të rëndësishëm në motivimin e nxënësve në të nxënit e lëndës së historisë si dhe shfrytëzimi i teknikave dhe metodave të ndryshme mësimore në mësimdhënien e historisë e nxitë kureshtjen e nxënësve për të nxënë, të dy hipotezat e ngritura në punim pranohet duke u bazuar në rezultatet e të anketuarëve si dhe rezultatet e t-testit.

Fjalët kyçe: mësimdhënës, strategji, teknikë, motivim, shkollë, nxënës.

Kandidati/ja: 12. Albana Podvorica

Tema: Ndikimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin e njohurive të nxënësve të klasës së VI-të për trashëgiminë kulturore

ABSTRAKTI

Trashëgimia Kulturore është një shprehje e mënyrave të jetesës të zhvilluara nga një komunitet dhe të transmetuara nga brezi në brez, duke përfshirë zakonet, praktikat, vendet, objektet, shprehjet artistike dhe vlerat. Trashëgimia Kulturore shpesh shprehet si Trashëgimi Kulturore Jomateriale ose e Prekshme.

“Trashëgimi kulturore” përfshin trashëgiminë arkitekturale, trashëgiminë arkeologjike, trashëgiminë e luajtshme dhe trashëgiminë shpirtërore. Trashëgimia kulturore është pasqyrë e vlerave dhe e nivelit kulturor të një populli. Andaj edhe ky hulumtim synon të identifikojë ndikimin që kanë aktivitetet jashtëkurrikulare në zhvillimin e njohurive të nxënësve të klasës së VI-të për trashëgiminë kulturore.

Pyetja kryesore e parashtruar në këtë hulumtim është: Si ndikojnë aktivitetet jashtëkurrikulare në zhvillimin e njohurive të nxënësve të klasës së VI-të për trashëgiminë kulturore, e pasuar me një pyetje tjetër ndihmëse: Sa shpesh zhvillohen aktivitete jashtëkurrikulare që kanë për qëllim zhvillimin e njohurive të nxënësve të klasës së VI-të për trashëgiminë kulturore?

Dizajni i këtij hulumtimi është eksperimental kurse instrumenti që do të përdoret në këtë studim është para dhe pas testi me nxënësit e klasës së gjashtë.

Nga ky hulumtim pritet që të kuptohet si ndikojnë aktivitetet jashtëkurrikulare në zhvillimin e njohurive të nxënësve të klasës së gjashtë për trashëgiminë kulturore.

Fjalët kyçe: aktivitete jashtëkurrikulare, ndikim, njohuri, nxënës, trashëgimi kulturore;

Kandidati/ja: 13. Mirlinda Sadiku

Tema: Ndërlidhja e lëndës së Historisë me trashëgimin kulturore, në funksion të zhvillimit të kompetencës qytetare

ABSTRAKTI

Trashëgimia kulturore është trashëgimia e objekteve fizike dhe atributëve jomateriale të shoqërisë të trashëguara nga brezat e kaluar. Artikujt fizik përfshijnë vepra arti, letërsi, muzikë, objekte arkeologjike dhe historike, si dhe ndërtesa, monumente dhe vende historike, ndërsa atributet e paprekshme përfshijnë zakone, tradita dhe praktika shoqërore shpesh të bazuara në besimet estetike dhe shpirtërore dhe traditat gojore. Atributet jo -materiale së bashku me artefaktet fizike karakterizojnë dhe identifikojnë dallueshmërinë e një shoqërie.

Trashëgimia kulturore përfshin vendet, gjërat dhe praktikën që një shoqëri i konsideron të vjetra, të rëndësishme dhe të denja për ruajtje. Aktualisht është subjekt i rritjes së vëmendjes popullore dhe shkencore në mbarë botën, dhe qëllimi i tij konceptual po zgjerohet.

Metodat dhe teknikat të cilat do të përdoren për të realizuar këtë punim, kanë të bëjnë me kriteret me të cilat do të ndjekë në përzgjedhjen e literaturës. Mikse (e përzier), sasiore dhe cilësore, bazuar në qëllimet dhe pyetjet, pa përjashtuar edhe metodën e analizës teorike dhe statistikore. Sa i përket instrumenteve do të përdoren pyetësorin të cilin do ta realizojë me nxënësit e shkollave të mesme të ulëta në katër shkolla fillore të mesme të ulëta në komunën e Gjilanit dhe Ferizajit . Rezultatet kryesore të këtij hulumtimi synojnë të vërtetojnë dy hipoteza të këtij hulumtimi që janë: H1: Ndërlidhja e lëndës së Historisë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore ndikon në zhvillimin e kompetencës qytetare tek nxënësit dhe H2: Bashkëpunimi i mësimdhënësve të shkencave shoqërore ndikon pozitivisht në funksion të zhvillimit të kompetencës qytetare tek nxënësit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është ndikimi i lëndës së Historisë në realizim të kompetencës qytetare tek nxënësit. Hulumtimi do të realizohet në katër SH.F.M.U , prej tyre dy në Gjilan dhe dy në Ferizaj . Në Gjilan SH.F.M.U ‘Selami Hallaçi’ dhe SH.F.M.U ‘Thimi Mitko ’, ndërsa në Ferizaj SH.F.M.U ‘‘.Dituria ‘’ dhe SH.F.M.U ‘‘Vezir Jashari ’’. Niveli i klasëve në të cilët do të zhvillohet hulumtimi janë klasët VI , VII,VIII,IX nga shkollat e mesme të ulëta . Numri i respondentëve do të jetë 200, prej tyre 100 nxënës nga komuna e Gjilanit dhe 100 nxënës nga komuna e Ferizajit . Do të realizojmë dhe intervista me mësimdhënësit e lëndës së Historisë.

Fjalët kyçe: Mësimdhënie, trashëgimi kulturore, tekst shkollor, kurrikula, nxënës

Kandidati/ja: 14. Rina Ramshaj

Tema: Niveli i përdorimit të portfolios elektronike në vlerësimin e nxënësve gjatë pandemisë COVID-19

ABSTRAKTI

Temë diskutimi e këtij hulumtimi është niveli i përdorimit të e-portfolios në vlerësimin e nxënësve gjatë pandemisë Covid-19 në lëndën e TIK-ut. Ky hulumtim është mjaft i rëndësishëm sepse viteve të fundit në vendin tonë teknologjia e informacionit dhe e komunikimit është zhvilluar shumë dhe pandemia Covid-19 ka bërë që të rritet përdorimi i teknologjisë nga mësimmshënësist për ta organizuar procesin mësimor. Gjatë kësaj periudhe delikate të mësimdhënies dhe mësimnxënies, instrumentet që janë përzgjedhur për vlerësimin e nxënësve kanë qenë poashtu zgjedhje jo të lehta për t'u bërë. E-portfolio është shfrytëzuar si instrument në këtë kohë sepse përmes saj janë zbatuar kriteret dhe parimet e vlerësimit dhe në të njëjtën kohë ka qenë më argëtuese për nxënësist.

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është “Sa ka ndikuar përdorimi i portfolios elektronike në vlerësimin e nxënësve gjatë pandemisë Covid-19?”. Ky studim është realizuar në dy shkolla të mesme të larta në komunën e Prishtinës, “Xhevdet Doda” dhe “Ali Sokoli”. Mostër e hulumtimit janë gjithsej 120 nxënës, katër mësimdhënës të TIK-ut, njëdrejtor dhe një zëvendësdrejtor. Në këtë studim kemi përdorur metoda sasiore e cilësore, në mënyrë që të kemi të dhëna sa më relevante. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave janë intervistat gjysmë të strukturuar me menaxhmentine shkollave dhe mësimdhënësist, ndërsapyetësori është realizuar me nxënësist e klasave të njëmbëdhjeta të shkollave në fjalë.

Nga gjetjet tona kemi vërtetuar hipotezën e parë që thotë se “Përdorimi i portfolios elektronike në vlerësimin formativ gjatë pandemisë Covid-19, ka mundësuar zbatimin e parimeve bazë të vlerësimit të nxënësve në nivel të kënaqshëm”. Është vërtetuar edhe hipoteza e dytë e hulumtimit që konstaton se përdorimi i portfolios elektronike ndihmon nxënësist në nivel të shquar që të përforcojnë shkathtësitë e tyre funksionale në TIK. Këto përfundime na bëjnë të kuptojmë se e-portfolio ka patur një rol të rëndësishëm në formimin dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë, në periudhën e pandemisë Covid-19.

Fjalët kyçe: mësimi në distancë, pandemia Covid-19, e-portfolio, vlerësimi.

Kandidati/ja: 15. Dorentina Aliu

Tema: Qëndrimet dhe njohuritë e nxënësve të klasave të IX-ta në lidhje me efektet e duhanpirjes në shëndet dhe mjedis

ABSTRAKTI

Procesi i duhanpirjes është njëri nga problemet dhe kërcënimet serioze që i bëhet shoqërisë sonë. E një moshë që është më e atakuar është mosha e adoleshencës. Të rinjtë tanë janë bërë përdorues masiv të duhanit. Ekzistojnë shumë pak dokumente ose studime me të dhëna se sa konsumohet duhani tek të rinjtë dhe sa janë të informuar nxënësit për ndikimet shëndetësore dhe mjedisore.

Në fakt nuk ka nevojë për shumë studime sepse vetëm të analizosh hapësirën ose oborrin e shkollave në vëndin tonë do të shohësh një numër të konsiderueshëm nxënësish të cilët konsumojnë duhanin nga të dy gjinitë. Por shtrohet pyetja, a është e vetëdijshme shoqëria jonë, më saktë gjeneratat e reja, për efektet e duhanpirjes në shëndetin e tyre ose edhe për dëmet që i shkaktohet mjdisit nga përdorimi i duhanit? Pikërisht këtë diskurs ka trajtuar ky punim.

Punimi shqyrton njohuritë dhe qëndrimet e nxënësve në lidhje me pasojat që shkakton duhanpirja në shëndet dhe mjedis. Përveq ndikimeve negative shëndetësore që pak a shumë shoqëria janë të informuar, pak ose aspak të informuar janë për ndikimet e duhanpirjes në mjedis. Në Kosovë kjo çështje është shumë pak e trajtuar me moshat e reja megjithëse është një temë shumë e ndjeshme.

Duke parë dëmet ose ndikimet negative të duhanit në shëndet dhe mjedis atëherë ky studim ka vë në pah qëndrimet e nxënësve të klasave të IX-ta dhe njohuritë që kanë për çështjen e duhanpirjes. Të dhënat e hulumtimit janë përpunuar me ndihmën e programit kompjuterik Microsoft Excel. Për

të realizuar këtë studim është përdorur metoda e mbledhjes së të dhënave kuantitative. Instrumenti matës për mbledhjen e të dhënave sasiore është përpiluar në formë të pyetësorit i cili është përbërë nga pyetjet e mbyllura dhe të hapura, dhe është realizuar me një kampion prej 134 nxënësve të SHFMU "Ismet Rraci" të Komunës së Klinës.

Rezultatet e këtij hulumtimit treguan se nxënësit e

kësaj shkolle kanë qëndrime negative në lidhje me konsumimin e duhanit si dhe mund të vijmë në

përfundim se nxënësit kanë njohuri mbi ndikimet shëndetësore më shumë se për ndikimet

mjedisore të duhanpirjes.

Fjalët kyçe: Duhanpirja, ndikimet, njohuritë, qëndrimet, shëndeti

Kandidati/ja: 16. Demir Demiri

Tema: Përceptimet e nxënësve në lidhje me ndikimin e emocioneve pozitive në të nxënit e lëndës së gjeografisë

ABSTRAKTI

Ky hulumtim vë në qendër të studimit ndikimin e emocioneve pozitive në të nxënit e lëndës së gjeografisë te nxënësit e klasëve të teta. Përmes këtij studimi analizohet literatura dhe hulumtimet vendore dhe ndërkombëtare rreth ndikimit të emocioneve pozitive tek nxënësit në të nxënë, dhe më pas të dhënat e mbledhura ndërlidhen me të dhënat e marra përmes pyetësorit të realizuar me nxënësit e klasëve të teta në lëndën e gjeografisë. Emocionet jo rrallëherë janë një shqetësim në mjediset mësimore, çështja kryesore e këtij hulumtimi do të jetë ndikimi i emocioneve pozitive në aspektet kyçe të të nxënit si: vëmendja, motivimi dhe performanca si dhe shkaktarët e emocioneve pozitive te nxënësve. Në lidhje me shkaktarët e emocioneve pozitive jemi fokusuar në veçanti tek shkaktarët e emocioneve pozitive në mësim, gjegjësisht në lëndën e gjeografisë. Gjithashtu rreth ndikimit të tyre në të nxënë jemi fokusuar vetëm në lëndën e gjeografisë.

Instrumenti të cilin e kemi përdorur për mbledhjen e të dhënave ka qenë pyetësori i përbërë nga 22 pyetje për nxënësit e klasëve të teta në lëndën e gjeografisë. Ky pyetësor ka përmbajtur pyetje për të identifikuar lehtësitë që emocionet pozitive shkaktojnë në të nxënit e gjeografisë. Një tjetër aspekt të cilin jemi përpjekur të identifikojmë ka qenë se si ndikimi mjedisit social (mjedisi i shkollës), raportet pozitive mesimdhënës-nxënës dhe raportet me bashkëmoshatarët mund të shkaktojnë emocione pozitive, dhe njëkohësisht ndikimin e tyre pozitiv në të nxënë. Metodologjia e përdorur për realizimin e hulumtimit është kryesisht sasimore, ku të dhënat janë analizuar përmes metodës statistikore. Për analizimin e të dhënave është përdorur programi SPSS.

Nga analiza dhe përpunimi statistikor i të dhënave është gjetur se emocionet pozitive kanë ndikim pozitiv në të nxënit e lëndës së gjeografisë nga nxënësit e klasëve të teta. Ky hulumtim në këtë vështrim është një arritje ndihmëse për mesimdhënësi dhe prindërit që punojnë me këtë moshë të nxënësve.

Fjalët kyçe: emocione pozitive, motivim, gjeografi, të nxënit.

Kandidati/ja: 17. Mirlinda Alija

Tema: Ndikimi i të nxënimit të bazuar në kërkim në të nxënimit për strukturat e komponimeve organike

ABSTRAKTI

Studime kanë treguar se studentët universitarë përfitojnë nga një kurs laboratorik i theksuar në të cilin ata përjetojnë konceptet themelore të kimisë në një kontekst që ilustron zbatime kërkimore praktike dhe aktuale. Kjo ka nxitur interesin e studentëve në kimi dhe të menduarit e pavarur të studentëve duke inkurajuar studentët të shikojnë përtej librave shkollorë dhe fakultetit për përgjigje. Në këtë hulumtim është vlerësuar se si mundën nxënësit ta kuptojnë drejt kiminë organike perkatesisht strukturën molekulare të komponimeve organike me përdorim të punës kërkuese. Qëllimi i studimit ishte të tregojë avantazhet e punës kërkimore në prezantimin, praktikën dhe shpjegimin e materialit mësimor në kimi, në krahasim me metodat tradicionale të mesimdhënis. Si metodologji për këtë hulumtim është përdorur metoda e përzier, sasiore dhe cilësore e cila mundësoi përgjigjen në pyetjet e hulumtimit. Si instrument për analizën sasiore është përdorur para dhe pas testi mbi njohuritë për strukturën molekulare organike, ndërsa intervista me një fokus grup shërbeu për analizë cilësore. Pastaj një pyetësor mbi qëndrimet e nxënësve rreth kësaj metodologjie të mësimdhënies, u zhvillua në fund. Rezultatet vënë në pah ndryshim signifikant ($p < 0.001$) në mes të klasës kontrollë dhe asaj eksperimentale në nivelin e njohurive të nxënësve për strukturën e komponimeve organike. Përderisa ekspozimi i të nxënimit përmes formës tradicionale gjatë tërë viteve të shkollimit ka bërë që perceptimet e tyre për punën kërkuese të mos jenë edhe më të definuara.

Fjalet kyçe: kërkim, kimi organike, strukturë, të nxënimit

Kandidati/ja: 18. Shahire Morina-Paçarizi

Tema: Sintaksa në shkollat e mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Në këtë punim është trajtuar Sintaksa në shkollat e mesme të ulëta, ku fokusi kryesor gjatë realizimit të punimit ka qenë përfaqësimi i sintaksës, si degë e rëndësishme e gjuhësisë, në librat shkollorë të shkollave fillore të mesme të ulëta. Po ashtu, gjatë hulumtimit, është shtjelluar shkalla e pranisë së njësive sintaksore në këto tekste, duke filluar nga togfjalëshi, gjymtyrët e fjalisë, fjalia dhe periudha.

Në tërë procesin e formimit kulturor edhe intelektual të nxënësve, pra në formimin e personalitetit të tyre, rol të madh pa dyshim që luajnë librat e gramatikës, sepse nëpërmjet tyre ata e fitojnë kulturën e të shkruarit, proces ky që do t'u nevojitet gjatë tërë jetës, prandaj me anë të këtij studimi, po ashtu, do të vihet në pah roli dhe rëndësia që ka sintaksa, e përfaqësuar në këto tekste, për formimin intelektual të nxënësve.

Në kuadër të realizimit të punimit kemi shfrytëzuar metodën kualitative (cilësore), literaturën bazë, si dhe literaturë adekuate për temën, dhe metodën kuantitative (sasiore) duke realizuar një pyetësor me nxënës. Punimit i jemi qasur në mënyrë analitike, duke e përdorur qasjen përshkruese, qasjen historike, si dhe atën krahasuese.

Fjalët kyçe: Gramatikë, gjuhë, sintaksë, gjymtyrë, fjali.